




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKAKOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Primalur / Dorezuar Prenjeno / Prilato Received / Delivered	16 - 03	2021	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shtojta e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBHCK	1192/2021		



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A. Nr. 79/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga Eshref Shabani, kryetar Arben Mehmeti, dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr. 79/2021 të datës 18.01.2021, së ankuesit përmes përfaqësuesit juridik avokatit me adresë banimi „Rruga „Dëshmoret e Kombit“, Ulpianë, nga Komuna e Prishtinës kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridik „kompensim material“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 16.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.79/2021 të datës 15.02.2021, të parashtruar nga ankuesi lidhur me pretendimet ankimore për kompensim prej 50% të pagës prej datës 22.09.2015 deri 10.05.2016 dhe pagave të plota nga data 10.05.2016 deri më datë 17.01.2018.

A r s y e t i m

Ankuesi nëpërmjet postës me datë 12.02.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në Këshill është pranuar më datë 15.02.2021 numër protoli:633/2021 dhe regjistruar me numër A.nr.79/2021, kundër Shërbimit Korrektues të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensim prej 50% të pagës prej datës 22.09.2015 deri 10.05.2016 dhe pagave të plota nga data 10.05.2016 deri më datë 17.01.2018.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.02.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Shërbimi Korrektues i Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 25.02.2021 ka

pranua nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, përgjigjen në kërkesë me numër protokolli: 831/2021, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 79/2021, me numër protokolli 633/2021, drejtua Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 08.02.2021; Vendimi i datës 21.01.2021; dëshmi nga banka; Kontrata e punës e datës 01.12.2010; Aktgjykimi APS . nr. . 21/2020, i Gjykatës së Apelit të Kosovës; Aktgjykimi PKR. Nr. 685/16, i Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Krime të Rënda; Aktgjykimi APS Nr. 21/2020, i Gjykatës së Apelit; Vendimi i datës 01.02.2021, i Komisionit Disiplinor; thirrje për intervistë e datës 22.01.2021; kërkesë e datës 22.01.2021, për inicimin e procedurës disiplinore; e- maili i datës 21.01.2021; vendimi i datës 21.01.2021; kërkesë e datës 25.11.2020, për kompensimin e pagës; Vendimi i datës 21.01.2021; vendimi i datës 03.05.2016, me numër protokolli 69/2016; vendimi i datës 03.05.2016, me numër protokolli 68/2016; vendimi i datës 03.05.2016, me numër protokolli 70/2016; aktvendimi i datës 23.09.2015, për suspendim nga puna me pagesë, për aktvendimi i datës 23.09.2015, për suspendim nga puna me pagesë, për aktvendimi i datës 23.09.2015, për suspendim nga puna me pagesë, për kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore; kontrata e punës e datës 01.12.2010, për kontrata e punës e datës 01.12.2010, për kontrata e punës e datës 01.12.2010, për Përgjigje në ankesë e datës 25.02.2021, me numër protokolli 83/2021, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është *jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.79/2021 të datës 15.02.2021, të parashtruar nga ankuesi, *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, dhe ka konstatuar që në bazë të Aktvendimit të datës 23.09.2015 të Drejtorit të Qendrës Korrektuese në Dubravë ankuesi është suspenduar nga puna me pagesë deri në përfundimin e hetimeve, ndërsa më datë 03.05.2016 Drejtori i Qendrës Korrektuese në Dubravë ka nxjerr Vendim me të cilin ankuesi i ndërpritet largimi i përkohshëm nga puna me pagesë deri në vendim përfundimtar të gjykatës kompetente.

Më datë 17.01.2018 U.D. i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës ka nxjerr Vendim me Nr. 020 me të cilin ka bërë shfuqizimin e vendimit të datës 03.05.2016, me çka edhe ankuesi është kthyer në vendin e punës.

Me Aktgjykimin PKR.nr.685/16 i datës 06.05.2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda dhe Aktgjykimin APS.nr.21/2020 i datës 30.10.2020 i Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti Special, është vendosur për rastin e ankuesit.

Ankuesi më datë 25.11.2020 për Shërbimin Korrektues të Kosovës ka parashtruar kërkesë për kompensim të pagave prej 50% të pagës prej datës 22.09.2015 deri 10.05.2016 dhe pagave të plota nga data 10.05.2016 deri më datë 17.01.2018. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 21.01.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 0172 me të cili ka refuzuar kërkesën e datës 25.11.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për kompensim prej 50% të pagës prej datës 22.09.2015 deri 10.05.2016 dhe pagave të plota nga data 10.05.2016 deri më datë 17.01.2018, dhe ka konstatuar që ankuesi ka themeluar marrëdhënie pune me Shërbimin Korrektues të Kosovës si "Zyrtar Korrektues" bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-212 të Punës dhe Ligjit Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, kurse bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, zyrtarët e shërbimit korrektues nuk janë kategorizuar si shërbyes civil, respektivisht me nenin 4 paragrafin 1 përcaktohej se: *"Në bazë të këtij ligji, statusi i nëpunësit civil nuk aplikohet për kategoritë e mëposhtme: stafi mësimor i sistemit arsimor, stafi mjekësor i sistemit shëndetësor, krijuesit dhe përformuesit e artit, zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës, zyrtarët doganorë të Doganave të Kosovës, zyrtarët korrektues të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, të emëruarit politik dhe të gjithë ata që emërohen në pozita nga të emëruarit politik dhe anëtarët e kabineteve të tyre, që nga kabineti i Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe kabinetet e ministrave. Marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me Ligjin e Punës, ligje të veçanta, me marrëveshje kolektive ose me rregullore sektoriale"*, mirëpo bazuar në Ligjin Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga 09.07.2021 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr. 1583/20 te datës 09.07.2020 përkatësisht nenit 4 paragrafit 1 i cili përcakton se: *"Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë"*, rrjedhimisht Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se nëpunësit e Shërbimit Korrektues të Kosovës nga data 09.07.2021 kanë statusin e nëpunësve civil me status të veçantë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga shqyrtimi i provave të lëndës, ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me kompensimin prej 50% të pagës prej datës 22.09.2015 deri 10.05.2016 dhe pagave të plota nga data 10.05.2016 deri më datë 17.01.2018 i referohen periudhës ndërmjet datës 29.09.2015 dhe datës 17.01.2018, andaj duke pas parasysh faktin që ligjet parimisht nuk kanë fuqi prapavepruese, atëherë sipas vlerësimit të Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil nuk ka kompetencë që të shqyrtoj pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me periudhën në të cilën ankuesi nuk kanë pasur statusin e shërbyesit civil, respektivisht për kohën ku në raport me zyrtarët korrektues nuk ka qenë i zbatueshëm legjislacioni për Shërbimin Civilë.


Në bazë të lartcekurave dhe bazuar në nenin 6 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civilë si dhe duke marrë parasysh konstatimin se pretendimet ankimore të ankuesit i referohen periudhës gjatë të cilës ankuesi nuk kanë pasur statusin e nëpunësit civil, atëherë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur pretendimet ankimore të ankuesit sipas ankesës A.nr.97/2021 të datës 15.02.2021 të parashtruar nga ankuesi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 79/2021


Esmyref SHABANI
Kryetar i Kolegjit


Rushit KAJTAZI
Procesmbajtës

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Përfaqësuesit Juridik Avokatit
Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së